


QËNDRUESHMËRIA E OSHC-VE: 3.7



Shqipëria përjetoi një sërë zhvillimesh të rëndësishme përgjatë vitit 2020. Pas tërmetit shkatërrues në nëntor 2019, përfaqësuesit e 100 vendeve premtuan një shumë rekord prej 1.1 miliardë eurosh (400 milionë euro në grante dhe 700 milionë euro në hua të buta) për rimëkëmbjen e Shqipërisë nga tërmeti në Konferencën Ndërkombëtare të Donatorëve Së Bashku për Shqipërinë, organizuar nga Komisioni Evropian (KE).

COVID-19 u shfaq për herë të parë në vend në mars 2020. Qeveria mori menjëherë masa duke urdhëruar një bllokim kombëtar (*lockdown*) i cili zgjati deri në fillim të qershorit. Ekonomia e dobët e Shqipërisë pasi u godit rëndë nga tërmeti i vitit 2019 u dobësua më tej për shkak të pandemisë. Raporti i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor i Bankës Botërore vuri në dukje përkeqësimin e punësimit, prodhimin të brendshëm bruto (PBB) dhe bilancet e jashtme dhe fiskale në vitin 2020. Qeveria shqiptare miratoi dy paketa të ndihmës financiare për të siguruar mbështetje sociale për qytetarët dhe bizneset, të cilat nuk përfshinë OSHC-të. Pandemia gjithashtu theksoi brishtësinë e demokracisë në vend: u pezullua e drejta për të protestuar, u kufizua ndjeshëm lëvizja dhe shumica e masave shtetërore ishin të centralizuara dhe u paraqitën nga kryeministri përmes akteve normative, pa miratimin e parlamentit, dhe gjithashtu pa përfshirë OSHC-të në konsultimet ose organet e reagimit ndaj krizave. Një deklaratë e përbashkët e OSHC-ve, e udhëhequr nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, theksoi se dënimet e propozuara në kodin penal për shkeljen e masave për të parandaluar përhapjen e virusit cenonjë të drejtat dhe liritë e qytetarëve. Rënia e besimit të publikut tek aftësia e qeverisë për të trajtuar pandeminë u bë edhe më e dukshme kur qytetarët dhe shoqëria civile u mbledhën në mënyrë të përsëritur në verë dhe vjeshtë për të protestuar kundër rregullave të qeverisë ndaj pandemisë, përfshirë ndryshimet në kodin penal, detyrimin për mbajtjen e maskës dhe vaksinimin e supozuar si të detyrueshëm.

Bazuar në aktet normative të miratuara për të luftuar përhapjen e COVID-19, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor gjobiti dy herë dhe më pas urdhëroi mbylljen e televizionit Ora News (e cila është një media kritike ndaj qeverisë) për shkeljen e kufizimeve të vendosura nga qeveria pasi kishte më shumë sesa një të ftuar në një emision televiziv. Ky veprim vuri në pikëpyetje nivelin e përkeqësuar të lirisë së shprehjes në vend. Raporti i vjetor i KE-së për Shqipërinë në vitin 2020 "ngriti shqetësime në lidhje me rritjen e censurës dhe vetëcensurës (midis gazetarëve), dhe në lidhje me pengesat e mundshme të lirisë së shprehjes në vend."

*Kryeqyteti, popullsia, dhe PBB-ja janë marrë nga Agjencia Qendrore e Inteligjencës, The World Factbook, i disponueshëm online në <https://www.cia.gov/the-world-factbook/>. Të dhënat e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor janë të disponueshme në <http://hdr.undp.org/en/composite/HDI>. Të dhënat e Lirisë në Botë janë të disponueshme në <https://freedomhouse.org/reporttypes/freedom-world>.

Protestat e shoqërisë civile arritën kulmin pas datës 8 dhjetor kur një oficer policie qëlloi për vdekje një njëzet e pesë vjeçar në Tiranë për shkak të shkeljes së aktit normativ për ndalimin e lëvizjes. Megjithatë oficeri i policisë u arrestua dhe u akuzua për vrasje me dashje, protestat e qytetarëve qenë të shumta. Disa protesta të dhunshme dhe jo të dhunshme që u zhvilluan në Tiranë dhe qytete të tjera rezultuan në dorëheqjen e Ministrisë të Brendshme.

Qëndrueshmëria e përgjithshme e sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri nuk pësoi ndryshime gjatë vitit 2020. Qëndrueshmëria financiare e OSHC-ve u përkeqësua pasi pati një regres të konsiderueshëm si në nivelet ashtu edhe në llojet e financimit në dispozicion të OSHC-ve. Pavarësisht se OSHC-të u përballën me një numër kufizimesh, ato plotësuan kërkesën në rritje për shërbime si rrjedhojë e krizës COVID-19 duke përmirësuar kështu dimensionin e ofrimit të shërbimeve. Dimensionet e tjera të qëndrueshmërisë mbetën kryesisht të pandryshuara.

Sipas Gjykatës së Shkallës së Parë në Tiranë, deri në fund të vitit 2020 në Shqipëri rezultojnë të regjistruara 11,962 OSHC. Ky numër përfshin 6,331 shoqata, 1,442 qendra dhe 742 fondacione. Në vitin 2020, u regjistruan gjithsej 223 organizata të reja (138 shoqata, 63 qendra dhe 22 fondacione). Në fund të vitit 2020, 4,972 OSHC, përfshirë 175 organizata të regjistruara rishtazi, ishin të regjistruara në organet tatimore.

MJEDISI LIGJOR: 3.7



Mjedisi ligjor për OSHC-të nuk pësoi shumë ndryshime gjatë vitit 2020. Megjithatë, OSHC-të u prekën drejtpërdrejt nga legjislacioni i miratuar për të luftuar pandeminë COVID-19. Një sërë projektligjesh që synuan rregullimin e mjedisit ligjor të OSHC-ve në Shqipëri u prezantuan përgjatë vitit.

Procedurat për regjistrimin dhe çregjistrimin e OSHC-ve nuk pësuan ndryshime gjatë vitit 2020. Këto procedura mbetën të centralizuara në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe vazhduan të jenë burokratike, të gjata dhe të

kushtueshme. Në përpjekje për të zvogëluar këto kufizime dhe për të adresuar një nga prioritetet e *Udhërrëfyesit për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (2019-2023)*, në fillim të vitit 2020, Ministria e Drejtësisë filloi projektligjin *Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse*. Pas një procesi konsultimi që filloi në qershor 2020, projektligji hyri në procedurën parlamentare në shtator 2020. Ndonëse komuniteti i OSHC-ve mirëpriti nismën ligjore, në të njëjtën kohë vërejti se projektligji ishte shumë problematik, duke arritur në përfundimin se ky projektligj mund ta vendosë sektorin – veçanërisht OSHC-të e përfshira në llogaridhënien e organeve publike dhe aktivitetet mbikëqyrëse - nën presion dhe kërcënim të shtuar.

Procedurat e ngadalta gjyqësore kanë ndikuar në qëndrueshmërinë financiare dhe veprimtarinë e OSHC-ve, të cilat janë ligjërisht të detyruara të konfirmojnë ose përditësojnë mandatet e organeve të tyre të brendshme vendimmarrëse, si dhe ndryshimet në statutet e tyre, përmes një vendimi të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Ndërkohë që këto rishikime janë akoma pezull, OSHC-të kanë qasje të kufizuara në llogaritë e tyre bankare, që nënkupton se ato nuk mund të bëjnë ose marrin pagesa, gjë që pengon vazhdimin e punës së tyre.

Në vijim të legjislacionit për luftën kundër pastrimit të parave, Ligji Nr. 154/2020 *Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare* hyri në fuqi në janar 2021. Para miratimit të tij, një grup i OSHC-ve ngriti shqetësimin se projektligji "nuk i nënshtrohet garancive kushtetuese të shtetasve dhe personave juridike, përfshirë edhe OJF-të (organizatat jofitimprurëse)" pasi nuk siguron mekanizma të mjaftueshëm për të ruajtur privatësinë e të dhënave dhe rrezikon rritjen e ndërhyrjes së shtetit në punën e tyre.

Në shtator dhe dhjetor 2020, Këshilli i Ministrave miratoi dy akte nënligjore për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR), bazuar në Ligjin Nr. 75/2019 *Për Rininë*. AKR do të mbështesë dhe financojë aktivitetet në sektorin e politikave rinore, në të cilin veprojnë shumë OSHC. Ligji Nr. 45/2016 *Për Vullnetarizmin* vazhdon të kërkojë një procedurë të gjatë dhe të centralizuar për regjistrimin e vullnetarëve që ndihmojnë OSHC-të. Procedura

është e vështirë, veçanërisht për organizatat rinore lokale, të cilat angazhojnë shumë vullnetarë dhe duhet të regjistrojnë dhe çregjistrojnë secilin prej tyre veç e veç sipas kohëzgjatjes së kontratës ose angazhimit. Procedura zhvillohet vetëm në kryeqytet dhe është veçanërisht e kushtueshme për OSHC-të jashtë Tiranës.

I filluar në vitin 2019, projektligji *Për Prokurimin Publik* u vu në dispozicion për konsultim publik në fillim të vitit 2020. Ministria e Financave zhvilloi një sërë takimesh me përfaqësues të shoqërisë civile, donatorë të huaj, shoqata biznesi dhe sipërmarrje sociale gjatë janarit dhe shkurtit 2020. Ligji u miratua nga parlamenti në dhjetor 2020 dhe hyri në fuqi në mars 2021. Ai pritet të lehtësojë dhe thjeshtojë procedurat e kontraktimit të OSHC-ve, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve. Mbrojtja civile, emergjencat civile dhe shërbimet e parandalimit të rrezikut të ofruara nga OSHC-të, si dhe projektet e financuara plotësisht nga ndërkombëtarët, do të përjashtohen nga praktikatat e prokurimit publik. Ndërsa OSHC-ve u njihet e drejta të marrin pjesë në prokurimet publike për shërbime të veçanta mjekësore, sociale dhe kulturore, gama e plotë e shërbimeve dhe rregullat e prokurimit që do të zbatohen për to priten të detajohen me një Vendim të Këshillit të Ministrave.

Në përgjithësi, ligjet që rregullojnë sektorin i mundësojnë OSHC-ve të veprojnë lirshëm dhe të kundërshtojnë vendimet e qeverisë në gjykatë. Megjithatë, studimi i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) *Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrjen në Shqipëri* ngriti shqetësimin se hapësira qytetare po kapet nga interesat politike. Një raport nga Zëri i Amerikës në shkurt 2020 tregoi se politikanët e rangut të lartë përdorin padi kundër kritikëve të tyre, përfshirë përfaqësuesit e mediave. Disa gazetarë u paditën nga autoritetet shtetërore dhe dy u arrestuan teksa raportonin për protestat e dhjetorit 2020. OSHC-të dhe shoqatat e mediave i konsideruan këto akte si përpjekje të shtetit për të frikësuar dhe sulmuar median.

E drejta e tubimit u kufizua plotësisht nga masat shëndetësore kundër COVID-19. Disa akte të nxjerra nga qeveria ndaluan organizimin e ngjarjeve shoqërore, kulturore dhe sportive, ose kufizuan ndjeshëm numrin e pjesëmarrësve në to. Përveç kësaj, u kufizua dhe u ndalua e drejta për tubim paqësor. Nga maji deri në dhjetor, shumë aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë u arrestuan për pjesëmarrje në tubime të paligjshme.

Politikat tatimore patën një përmirësim të lehtë gjatë vitit 2020, pasi qeveria miratoi disa masa nga të cilat përfitojnë të gjitha sipërmarrjet, përfshirë OSHC-të. Për shembull, tani OSHC-të mund ta pezullojnë përkohësisht aktivitetin e tyre nëse nuk kanë të ardhura, pa grumbulluar detyrime tatimore të papaguara gjatë asaj periudhe. Për më tepër, pragu minimal për regjistrimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) u rrit nga 2 milionë lekë në 10 milionë lekë (afërsisht nga 19,200 dollarë në 96,200 dollarë) të qarkullimit vjetor, nga i cili përfitojnë sipërmarrjet sociale dhe profesionistët e pavarur që bashkëpunojnë me sektorin e shoqërisë civile. Më parë, profesionistët e pavarur i nënshtroheshin regjistrimit të TVSH-së, pavarësisht nga të ardhurat e tyre vjetore. Përndryshe, OSHC-të trajtohen në mënyrë të ngjashme me subjektet e tjera të tatueshme, gjë që kufizon zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit. Taksat vendore të tilla si taksa e pronës, tabelave dhe taksa e mjedisit shtojnë një barrë të konsiderueshme për financat e organizatave, veçanërisht të atyre që merren me ofrimin e shërbimeve.

Mundësitë ligjore për mobilizimin e burimeve financiare mbetën të pandryshuara gjatë vitit 2020. Një OSHC mund të angazhohet në aktivitete ekonomike për të gjeneruar të ardhura, me kusht që të ardhurat të mos përbëjnë më shumë se 20 përqind të buxhetit të saj të përgjithshëm vjetor. Individëve dhe korporatave vazhdon t'u mungojë stimuli tatimor për t'i bërë dhurime OSHC-ve.

OSHC-të kanë akses të kufizuar në ekspertizën e specializuar ligjore, e cila është e përqendruar kryesisht në Tiranë. Megjithatë, OSHC-të kanë rritur kapacitetet e tyre të brendshme për të ofruar mbështetje ligjore për individët dhe organizatat jashtë kryeqytetit. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë ka në funksion qendra të ndihmës juridike falas nëpër Shqipëri. Gjatë vitit 2020 u hapën katër qendra të reja, ndërkohë që tre të tjera u rivitalizuan, dhe dymbëdhjetë OSHC u autorizuan të ofrojnë ndihmë juridike falas të financuar nga buxheti i shtetit. Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) solli shërbimin e ndihmës juridike online *Juristi Online* në prill 2020, i cili ofron ndihmë juridike falas si për individët ashtu edhe për OSHC-të.

KAPACITETI ORGANIZATIV: 3.6

Kapaciteti organizativ i OSHC-ve nuk pësoi shumë ndryshime gjatë vitit 2020. Pavarësisht sfidave të shkaktuara nga kriza COVID-19, OSHC-të morën iniciativën për t'iu përgjigjur nevojave në rritje të komuniteteve të tyre gjatë



pandemisë. Vërehet gjithashtu një përmirësim i dukshëm në aksesin e OSHC-ve në teknologji dhe përdorimin e platformave të ndryshme online, të cilat OSHC-të i përdorën për të komunikuar me komunitetet dhe grupet e interesit. Megjithatë, pandemia solli edhe disa efekte negative në aspektet e punës së OSHC-ve. Veprimtaria e OSHC-ve u paralizua gjatë bllokimit kombëtar duke dobësuar aftësinë e tyre për të arritur objektivat e parashikuara. Për më tepër, disa OSHC – veçanërisht ato të vogla dhe në zona të largëta – nuk e kishin të lehtë të

përshtateshin me shkëputjen fizike nga komunitetet e tyre, kalimin në formatin dixhital dhe qasjen në fonde, duke rrezikuar kështu qëndrueshmërinë e tyre. Hendeku në kapacitetet e OSHC-ve qendrore dhe atyre vendore ishte gjerësisht shproporcional edhe në vitin 2020. Sikurse vihet në dukje në studimin e IDM-së në vitin 2020 *Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimarrjen në Shqipëri*, organizatave jashtë Tiranës u mungon kapaciteti institucional për t'u zhvilluar, mbledhur fonde, monitoruar dhe vlerësuar punën e tyre, si dhe për të lobuar në mënyrë efektive.

Duke pasur parasysh që pothuajse të gjitha aktivitetet u zhvilluan online gjatë vitit, stafet e OSHC-ve rritën ndjeshëm njohuritë dhe aftësitë e tyre për të punuar në një mjedis dixhital. Shumë OSHC raportuan se ato rritën komunikimin me komunitetet e tyre përmes përdorimit të Zoom dhe platformave të tjera online. Megjithatë, OSHC-të e tjera raportuan se aktivitetet dhe ndërveprimi i tyre me komunitetet lokale, veçanërisht ato që nuk kanë qasje në teknologji dhe internet, u tkurrën. OSHC-të pezulluan aktivitetet e tyre në terren në fillim të marsit dhe i rifilluan ato në qershor kur Shqipëria u rihap. Sidoqoftë, komunikimi dhe ndërveprimi me komunitetet mbetën shumë të vështira përgjatë gjithë vitit, për shkak të distancimit social dhe masave të tjera parandaluese. Vetëm pesë prej nëntëdhjetë OSHC-ve të anketuara në vlerësimin e Partnerëve Shqipëri (PSH) besonin se ishin në gjendje t'i arrinin plotësisht dhe, deri diku, t'u shërbenin përfituesve të projekteve të tyre. Një numër i madh i OSHC-ve raportuan se ato ishin në gjendje të ofronin shërbime vetëm për 60 për qind të përfituesve të tyre dhe 22 OSHC raportuan se nuk ofruan aspak shërbime për përfituesit e tyre. Vlerësimi i PSH zbuloi gjithashtu se OSHC-të vazhduan të zbatojnë 47 projekte (nga 159 të raportuara) online, por pezulluan zbatimin e 112 projekteve.

Edhe pse vullnetarët janë një burim i rëndësishëm njerëzor për OSHC-të, nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e vullnetarëve të angazhuar në këtë sektor. Shumica e OSHC-ve ende nuk njohin kuadrin ligjor mbi vullnetarizmin. Për më tepër, regjistri kombëtar i vullnetarëve në Shërbimin Kombëtar të Punësimit nuk është akoma funksional. Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri 2019 tregon se shumica e OSHC-ve të anketuara (64 për qind) kanë më pak se dhjetë vullnetarë, ndërsa 7 për qind kanë më shumë se gjashtëdhjetë vullnetarë. Në përgjithësi, OSHC-të me një numër të madh vullnetarësh janë organizata rinore, të cilat organizojnë fushata masive ndërgjegjësimi.

Ndërsa OSHC-të e mëdha kanë përgjithësisht misione të përcaktuara mirë, OSHC-të e vogla janë më të prirura të kenë misione më të gjera të cilat u lejojnë atyre të konkurrojnë për një gamë të gjerë financimesh nga donatorët. Siç është vërejtur në studimin e IDM-së *Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimarrjen në Shqipëri*, OSHC-të i përshtatin aktivitetet e tyre sipas axhendave të donatorëve dhe mundësive të financimit, më shumë sesa për arritjen e misioneve të tyre, gjë që kufizon ndikimin e tyre në terren dhe dobëson besueshmërinë e tyre në komunitetet ku ata veprojnë.

OSHC-të janë angazhuar gjithnjë e më shumë në planifikimin strategjik gjatë viteve të fundit për shkak të programeve të donatorëve që kanë përmirësuar kapacitetet e sektorit. Përveç kësaj, studimet e fundit mbi sektorin raportojnë se shumica e OSHC-ve kanë politika dhe procedura të brendshme organizative, përfshirë strukturat e brendshme të menaxhimit, edhe pse në një farë mase, këto janë formale dhe jo gjithmonë efektive. Megjithatë, OSHC-të u përpoqën të përmirësojnë më tej planifikimin e tyre strategjik dhe menaxhimin e brendshëm gjatë vitit 2020. Kalimi i punës në


distancë krijoi një mbingarkesë pune për stafin e OSHC-ve, duke kufizuar kapacitetin e tyre për t'u angazhuar në mënyrë efektive në planifikimin strategjik organizativ si dhe monitorimin dhe vlerësimin e punës së tyre.

Mungesa e financimit publik për sektorin e bëri të vështirë për OSHC-të që të paguajnë pagat e stafit dhe kostot e tjera të punës në vitin 2020, duke kërcënuar kështu të gjithë veprimtarinë e tyre. Sipas vlerësimit të PSH-së, vetëm dyzet e gjashtë nga nëntëdhjetë OSHC të anketuara deklaruan se mund të paguanin pagat e stafit të tyre, ndërsa njëzet deklaruan se nuk kishin fonde në dispozicion për pagat. Vetëm katërbëdhjetë OSHC u përgjigjën se mund të mbulonin plotësisht shpenzimet e tyre administrative, ndërsa tridhjetë e nëntë deklaruan se nuk kishin fonde për të mbuluar këto kosto. Për më tepër, pandemia dhe më konkretisht nevoja për të punuar në distancë ndikuan negativisht në performancën e stafit dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Vlerësimi i PSH-së zbuloi se vetëm pesëmbëdhjetë nga nëntëdhjetë OSHC të anketuara përdorin në mënyrë efektive platformat online për koordinimin e brendshëm, takimet me grupet e interesit dhe ofrimin e trajnimeve. Gati gjashtëdhjetë OSHC raportuan se kanë nevojë të madhe për qasje në aplikacionet ku zhvillohen takime online dhe dymbëdhjetë OSHC kishin mungesë të pajisjeve të nevojshme për të punuar nga shtëpia.

QËNDRUESHMERIA FINANCIARE: 4.5

Qëndrueshmëria financiare e OSHC-ve pësoi një përkeqësim të lehtë gjatë vitit 2020 pasi kriza COVID-19 shkaktoi një efekt negativ në mbledhjen e fondeve, diversifikimin e burimeve të financimit, si dhe menaxhimin financiar efektiv të granteve dhe financimeve të akorduara. Qëndrueshmëria financiare është veçanërisht e dobët për OSHC-të lokale,



veçanërisht ato në zonat e largëta, për shkak të kapacitetit të tyre të kufizuar organizativ dhe vështirësive në qasjen dhe administrimin e fondeve.

Sipas anketës së PSH-së, në mars 2020 institucionet e Bashkimit Evropian (BE) (përfshirë Delegacionin e BE-së dhe KE-së) janë donatorët më të spikatur të OSHC-ve, të ndjekur nga ambasadat dhe agjencitë e zhvillimit, siç është Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), USAID, dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP). Institucionet

shtetërore, përfshirë ministritë e linjës dhe bashkitë, janë donatorët e tretë më të rëndësishëm. Përveç kësaj, dymbëdhjetë nga nëntëdhjetë OSHC-të e anketuara raportuan se kishin marrë disa financime nga sektori privat.

Donatorët e huaj dhe ata vendas pezulluan skemat dhe shërbimet e ndryshme të financimit për shkak të përhapjes së COVID-19 dhe masave parandaluese ndaj tij, dhe disa i devijuan financimet e tyre në përgjigje të pandemisë. Megjithatë donatorët demonstuan fleksibilitet të konsiderueshëm duke lejuar OSHC-të që të përshtatin projektet e tyre në zhvillim të kontekstit të ri pandemik, OSHC-të e kishin ende të vështirë të menaxhonin fondet e tyre të alokuara më parë, pasi ato ishin të kufizuar nga masat parandaluese të COVID-19, si dhe problemet shëndetësore të stafit të tyre të infektuar me COVID-19.

Skemat e nëngrantimit siguruan mbështetje të rëndësishme financiare për sektorin. LëvizAlbania, me financim nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), rriti numrin e thirrjeve për propozime projektesh në vitin 2020 dhe lançoi një instrument fleksibël financimi të quajtur *Reagimi i Shpejtë*. Të shtyrë si nga tërmeti i vitit 2019 ashtu edhe nga pandemia COVID-19, OSHC-të paraqitën një total prej 230 aplikimesh gjatë raundit të parë të financimit në vitin 2020, krahasuar me një mesatare prej 50 deri në 59 aplikime në katër vitet e mëparshme. Gati 320 propozime projektesh u paraqitën në thirrjen e dytë nga individë dhe grupe joformale, në vijim të 140 propozimeve të OSHC-ve. Nëpërmjet këtyre dy thirrjeve për propozime projektesh, LëvizAlbania ofroi gjithsej shtatëdhjetë grante. Asnjë nga OSHC-të që morën grante nuk ishin në gjendje të siguronin bashkëfinansim, duke treguar kështu mungesën e pranisë së donatorëve të tjerë në vitin 2020.

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) ofroi grante deri në 3,500 euro për gjashtë organizata, secila prej tyre e fokusuar në zbatimin e nismave të sipërmarrjes së gjelbër. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në partneritet me Institutin për Studime Politike, si dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile, ofruan një total prej 90,000 eurosh nëngrante për OSHC-të lokale për të promovuar dhe monitoruar proceset demokratike. Sidoqoftë, OSHC-të e interesuara hasën vështirësi në paraqitjen e aplikimeve të tyre për shkak të sfidave për të mbledhur të dhëna dhe/ose për t'u konsultuar me përfituesit e projekteve të tyre në mes të pandemisë.

Studimi i IDM-së në dhjetor 2020 *Zmbrapsja demokratike dhe tkurrja e hapësirës qytetare - Si ta ndryshojmë trendin?* konstatoi se ndarja e fondeve publike vazhdon të jetë e kufizuar dhe jotransparente. Sipas Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) (e cila është burimi kryesor i financimit shtetëror për sektorin) viti 2020 shënoi nivelin më të ulët të financimit publik në dispozicion të OSHC-ve gjatë pesë viteve të fundit. Për më tepër, gati gjysma e buxhetit të caktuar për thirrjet për propozime të AMSHC-së në vitin 2020 u ri-caktua në fillimin e përhapjes së COVID-19 tek njësitë e tjera. OSHC-të nuk përfituan nga asnjë prej paketave të mbështetjes financiare të miratuara nga qeveria për të zbutur ndikimet ekonomike të pandemisë.

Raporti vjetor i KE-së për vitin 2020 për Shqipërinë thekson faktin se qëndrueshmëria financiare e OSHC-ve mbetet një sfidë për shkak të kuadrit të pafavorshëm fiskal dhe ligjor. Edhe pse procedura e re e rimbursimit të TVSH-së për OSHC-të (si përfituese të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimin) mbeti në fuqi në vitin 2020, Matrica e Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri 2019 raportoi se vetëm 15 përqind e OSHC-ve të anketuara përfituan nga përjashtimi i taksave.

Sipas monitorimit të aktivitetit filantropik nga PSH, në vitin 2020 popullsia shqiptare dhuroi gjithsej 844,000 EUR donacione. Vërehet një rënie e konsiderueshme krahasuar me vitin 2019, kur shuma e dhuruar tejkaloi 1.25 milionë euro, nga të cilat gati 10.9 milionë euro ishin në përgjigje të drejtpërdrejtë të tërmetit të nëntorit. Kjo rënie dramatike i atribuohet sfidave ekonomike dhe sociale të krijuara nga kriza COVID-19. Përafërsisht, një e katërta (25.54 përqind) e totalit të donacioneve në vitin 2020 u mblodhën përmes fushatave dhe eventeve të organizuara në përgjigje të pandemisë COVID-19 dhe pasojave të tërmetit të vitit 2019. Shumica e dhurimeve në vitin 2020 ishin në formën e parave (93 përqind). Përfituesit kryesorë ishin familjet e varfra, fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuar, fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror dhe viktimat e dhunës dhe trafikimit. Forma më e përhapur ishin dhurimet direkte për përfituesit, dhe pas saj, kanali i dytë më i shpeshtë i dhurimeve ishin OSHC-të. Dhurimet e kanalizuar përmes platformave *crowdfunding* të organizuara nga OSHC-të u renditën në vendin e tretë.

OSHC-të gjithnjë e më shumë angazhohen në ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë bizneset sociale (dmth. ofrimin e shërbimeve të plota) si një mënyrë për të diversifikuar të ardhurat e tyre. Një numër biznesesh sociale rrezikuan falimentimin në vitin 2020 për shkak të kufizimeve të vendosura nga COVID-19. Pavarësisht se këto biznese sociale paguanjë të gjitha taksat, ato nuk u përfshinë në paketat mbështetëse të qeverisë në përgjigje të pandemisë.

OSHC-të vazhdojnë t'i nënshtrohen inspektimeve operacionale për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit nga organet tatimore. Me përjashtim të organizatave të vogla, OSHC-të janë të detyruara të paraqesin auditime të pavarura.

ADVOKIMI: 3.2



OSHC-të intensifikuan aktivitetet e tyre të advokimit në përgjigje të sfidave dhe vështirësive që paraqiti viti 2020, megjithëse rezultatet përfundimtare të përpjekjeve të tyre për të ndikuar në politikën publike, legjislacionin dhe opinionin publik ishin të kufizuara dhe të përmbajtura prej vetë pandemisë. Gjatë të gjithë vitit, OSHC-të ndoqën misionet e tyre të advokimit duke publikuar deklarata dhe peticione publike, duke ngritur padi dhe duke kërkuar mbështetje ndërkombëtare për rastet dhe kauzat e tyre përkatëse.

Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik i kërkon qeverisë të organizojë konsultime publike për projektligjet në fazën përfundimtare të përgatitjes së tyre dhe krijon mekanizma për të angazhuar aktorë të shumtë në procesin e hartimit të ligjit. OSHC-të vazhduan të ankohen për sipërfaqësinë e këtij procesi gjatë vitit 2020. Sipas *Raportit të Monitorimit të Reformës në Administratën Publike (PAR) 2019-2020*, vetëm 36 përqind e OSHC-ve të anketuara besonin se procedurat e konsultimit kanë hapur rrugën për përfshirje efektive të publikut në procesin e politikëbërjes. Vetëm 4 përqind e OSHC-ve deklaruan se autoritetet reagojnë shpesh ndaj sugjerimeve të tyre për hartimin e ligjeve.¹ Për më tepër, vetëm 8 përqind e OSHC-ve të anketuara konfirmuan se rekomandimet e tyre janë pranuar nga autoritetet gjatë procesit të konsultimit. Në të njëjtën kohë, 45 përqind e të anketuarve ranë dakord se kërkesat formale të parashikuara në ligj nuk zbatohen në mënyrë korrekte. Për shembull, projektligjet nuk ndahen me publikun në kohën e duhur, ndërsa në raste të tjera OSHC-të përjashtohen nga procesi i konsultimit. Ndryshimi i Kodit Zgjedhor në qershor 2020 u karakterizua nga këto dy lloj përjashtimesh.

Një sërë të dhënash tregojnë se qeveria i përdori masat kundër pandemisë për të penguar zhvillimin e protestave, angazhimin qytetar dhe konsultimet. Sipas raportit të *Freedom House Vendet në Tranzicion 2021*, "qeveria injoroi shumicën e rekomandimeve të shoqërisë civile në fushën e advokimit dhe politikave, si dhe shfrytëzoi pandeminë për të forcuar kontrollin e saj mbi hapësirën qytetare." Për më tepër, policia shpërndau tubimet qytetare dhe arrestoi qindra njerëz, ndërkohë që tubimet politike vazhduan normalisht. Në nivel lokal, OSHC-të shprehën shqetësimin se autoritetet lokale i përdorën kufizimet e pandemisë si justifikim për t'i përjashtuar ato dhe qytetarët nga konsultimet për buxhetet e bashkisë.

Një hap pozitiv që përdorimi i gjerë i teknologjisë i cili shërbeu si një mjet për të rritur pjesëmarrjen qytetare. Takimet online rritën transparencën në mbledhjet e komisioneve parlamentare, të cilat u bënë lehtësisht të aksesueshme për palët e interesuara nëpërmjet teknologjisë.

Pavarësisht kërkesave të tyre, OSHC-të nuk arritën të përfitonin nga dy paketat financiare të qeverisë gjatë bllokimit kombëtar prej pandemisë. Në prill, nën udhëheqjen e ANRD, një grup prej njëzet e katër organizatash i drejtuan një letër publike kryeministrit për sfidat dhe rekomandimet e mbështetjes së banorëve ruralë gjatë COVID-19. Pas një përgjigjeje të zymtë qeveritare, në qershor 2020 anëtarët dhe ish anëtarët e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) shprehën shqetësimin e tyre se roli i OSHC-ve ishte zvogëluar për shkak të masave të distancimit social kundër pandemisë dhe kërkuan që të lejohej organizimi i aktiviteteve në ambiente të mbyllura dhe të hapura, në përputhje me protokollet e miratuara shëndetësore. Në nëntor 2020, OSHC-të kërkuan ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së Policisë së Shtetit për moslejimin e tubimeve në ambiente të hapura nga ana e qytetarëve dhe miratimin e një protokollit Anti-COVID-19¹ për organizimin e protestave qytetare. Asnjë nga protokollet nuk u ofrua gjatë vitit dhe aktet kufizuese mbetën në fuqi. Pavarësisht numrit të shtuar të deklaratave

¹ *** Shifrat e rishikuara të raportit "Monitorimi i Reformës në Administratën Publike, Shqipëri 2019/2020", botuar pas finalizimit të këtij raporti, thonë se 7% e OSHC-ve deklarojnë se autoritetet reagojnë shpesh dhe gjithmonë ndaj sugjerimeve të tyre dhe 9.6% e OSHC-ve konfirmojnë se rekomandimet e tyre janë pranuar nga autoritetet gjatë procesit të konsultimit.

publike, nuk kishte mjaftueshëm koordinim brenda sektorit të OSHC-ve për të ndërmarrë veprime efektive dhe të vazhdueshme për t'i bërë presion qeverisë për të modifikuar politikat e saj.

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar arriti që të përfshinte kompleksin e Teatrit Kombëtar në listën e Europa Nostra-s si një nga shtatë monumentet më të rrezikuara të kulturës në Evropë për vitin 2020. Megjithatë, kjo mbështetje ndërkombëtare nuk mjaftoi për të parandaluar prishjen e teatrit. Vendimi i papritur i qeverisë për të transferuar pronësinë e godinës së teatrit tek bashkia e Tiranës dhe vendimi i menjëhershëm për ta shembur atë në mëngjesin e 17 majit, shkaktoi një valë protestash brenda dhe jashtë vendit. Disa nga këto protesta përshkallëzuan në përplasje me policinë dhe në arrestimin e shumë prej aktivistëve. Menjëherë pas kësaj, Aleanca paraqiti disa ankesa në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar duke kërkuar një hetim të pavarur mbi këtë rast. Aleanca gjithashtu nisi një peticion ku bënte thirrje për rindërtimin e teatrit në formën dhe në vendin ku ishte. Peticioni në internet u nënshkrua nga rreth 17,000 njerëz. Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, qeveria nuk i është përgjigjur kësaj thirrjeje.

Në vijim të dhunimit të një nxënëseje pesëmbëdhjetëvjeçare nga një roje shkolle, OSHC-të kombëtare dhe ndërkombëtare kërkuar nga qeveria që të adresonte abuzimin seksual të fëmijëve. Studentët dhe OSHC-të në të gjithë vendin marshuan paqësisht në qershor 2020, duke i kërkuar autoriteteve ta trajtojnë këtë fenomen. Në një ngjarje tjetër, gjashtëdhjetë e gjashtë OSHC mbështetën publikisht në tetor grevën e urisë së ish-punonjësve të rafinerisë së naftës në Ballsh, duke kërkuar nga qeveria respektimin e të drejtave të punëtorëve grevistë. Grevistët arritën eventualisht një marrëveshje me qeverinë në nëntor. Vrasja e një qytetari nga një oficer policie gjatë orës policore në dhjetor shkaktoi një seri protestash nga të miturit që përshkallëzuan edhe në dhunë. Disa OSHC i kërkuar policisë të ndalojë arrestimin e të miturve dhe të mbrojnë të drejtën për tubim paqësor.

Pas disa protestave nga komuniteti dhe OSHC-të e mjedisit, Gjykata Administrative në Tiranë shfuqizoi vendimin e Entit Rregullator të Energjisë për të lejuar ndërtimin e dy hidrocentraleve në parkun kombëtar të Zall-Gjoçaj. Klinikat e ligjit të OSFA-së i siguruan qytetarëve ndihmë juridike dhe përfaqësim në gjykatë.

OSHC-të ishin aktive në një numër nismash për të ndryshuar legjislacionin gjatë vitit 2020. Nisma Thurje dorëzoi një peticion në kuvend të nënshkruar nga më shumë se 50,000 qytetarë të cilët propozonin një projektligj për të reformuar sistemin zgjedhor, i cili nuk u miratua. Qendra për Çështjet e Informimit Publik (INFOÇIP) përmbylli një projektligj për referendumet në vitin 2020 pas një procesi të gjatë të filluar në vitin 2016. Ky projekt është ende në pritje të shqyrtimit nga parlamenti në vitin 2021. Pas shqetësimit të madh të publikut dhe një studimi të detajuar, në prill 2020, Ministria e Financave hoqi tatimin mbi fitimin nga donacionet e pronës midis anëtarëve të familjes, pas advokimit nga OSFA.

Në prill 2020, OSHC-të mbikëqyrëse dhe qendrat studimore i kërkuar kuvendit të ngadalësojë ndryshimet e Kodit Penal, të cilat kërkonin rritjen e dënimeve për shkeljen e dispozitave ligjore gjatë situatës së jashtëzakonshme. Sipas pikëpamjes së OSHC-ve, ndryshime të tilla shkelin të drejtat e njeriut dhe liritë civile, si dhe përbëjnë një kërcënim për demokracinë. Këto përpjekje për advokim dështuan dhe ligji u ndryshua në fund nga parlamenti.

Në maj 2020, Komisioni i Venecias e vlerësoi paketën e qeverisë Anti-Shpifje si "të pazbatueshme" dhe shumë problematike, duke mbështetur kështu shoqërinë civile në betejën e saj të vazhdueshme kundër kufizimeve dhe masave ndëshkuese të përcaktuara në rregulloren ligjore për median online. Edhe një herë, katërmëdhjetë OSHC i bënë thirrje qeverisë që të tërheqë paketën nga procedura legjislative dhe të mbështesë funksionimin e një organi vetë-rregullues për median. Advokimi për të përmirësuar këto projektligje në favor të një kuadri ligjor më miqësor pritet të vazhdojë gjatë vitit 2021.

Pas përpjekjeve të zgjeruara të advokimit që kërkojnë ndryshime në procedurat e regjistrimit për OSHC-të, në qershor 2020 Ministria e Drejtësisë filloi një proces konsultimi mbi projektligjin Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse. Sipas QKBSHC, grupi i punës mori parasysh vetëm 15 përqind të rekomandimeve të dhëna nga shoqëria civile për projektligjin fillestar. OSHC-të kërkuar konsultime të mëtejshme, duke argumentuar se projektligji e vë sektorin në rrezik nga rritja e kontrollit shtetëror dhe mbikëqyrja e strukturave të qeverisjes së brendshme dhe se ligji do të krijojë pengesa të mëtejshme për lirinë e organizatave.

OFRIMI I SHËRBIMEVE: 3.4



Ofrimi i shërbimeve të OSHC-ve u përmirësua disi në vitin 2020, pavarësisht kontekstit të ri social dhe ekonomik në të cilin punoi sektori për shkak të pandemisë. OSHC-të vazhduan të plotësojnë nevojat e popullsisë së prekur nga tërmeti i vitit 2019 dhe reagues ndaj krizës COVID-19 duke përshtatur shërbimet e tyre në kontekstin e ri. Siç u theksua në studimin e vitit 2020 të Westminster Foundation for Democracy (WFD) për *Rolin e Shoqërisë Civile dhe Medias në Menaxhimin e Krizave në Shqipëri*, puna e OSHC-ve gjatë pandemisë COVID-19 përfshiu rritjen e ndërgjegjësimit, shpërndarjen e informacionit, shpërndarjen e maskave, ofrimin e mbështetjes psikologjike online, zhvillimin e takimeve online me komunitetin, bamirësinë, donacionet

për grupet e marginalizuara, hulumtimet dhe studimet, si dhe eventet online të rrjetëzimit. Sidoqoftë, kërkesa për shërbimet e OSHC-ve u rrit për shkak edhe të tërmetit ashtu edhe pandemisë, dhe një numër i nevojave lokale nuk u trajtuan për shkak të mungesës së fondeve të OSHC-ve dhe bllokimit kombëtar.

Pandemia nga njëra anë i shtyu OSHC-të drejt rritjes së përdorimit të teknologjisë në ofrimin e shërbimeve, ndërsa nga ana tjetër e kufizoi ndërveprimin e tyre të drejtpërdrejtë me komunitetet lokale, autoritetet publike dhe aktorët e tjerë. Stafi i OSHC-ve që punonin nga shtëpia ishte në gjendje të ofronte mbështetje për komunitetet e tyre dhe ndërmori nisma të reja për të ofruar shërbime të kujdesit shëndetësor për pacientët me sëmundje kronike dhe në fusha të tjera. Sipas vlerësimit të PSH-së në mars 2020, shtatëdhjetë e pesë nga nëntëdhjetë OSHC të anketuara u përgjigjën se ato ofruan shërbime dhe produkte direkte, ndërsa gjashtëdhjetë e katër OSHC ofruan trajnime dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve. Një numër i madh i OSHC-ve raportuan se duke përshtatur metodologjinë e punës ata ishin në gjendje të kontaktonin dhe t'u shërbenin shumicës së përfituesve nga projektet e tyre. OSHC-të e anketuara u shërbyen grupeve të ndryshme, duke përfshirë të rinjtë, gratë, komunitetet rome dhe egjiptiane si dhe banorëve të zonave rurale.

Raporti i KE-së për vitin 2020 theksoi nivelin e pamjaftueshëm të financimit publik në dispozicion të aktiviteteve të OSHC-ve, në veçanti shërbimeve sociale. Në përgjithësi, institucionet publike në nivel kombëtar dhe lokal dështuan të mbështesin OSHC-të përmes paketave financiare në përgjigje të pandemisë dhe nuk u përpoqën mjaftueshëm për të avancuar më tej sipërmarrjen sociale ose për të krijuar partneritete me OSHC-të në ofrimin e shërbimeve sociale për komunitetet në nevojë. Një nga diskutimet e Konferencës Kombëtare të Shoqërisë Civile u përqendrua tek sfidat me të cilat përballen OSHC-të në ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë: burimet e kufizuara financiare, përfshirë këtu edhe mungesën e kriterëve të qarta për OSHC-të për të përfituar nga Fondi Social; fakti që disa lloje shërbimesh (p.sh., për personat me aftësi të kufizuara) nuk konsiderohen prioritete nga institucionet vendore; mënyrat se si taksat vendore dhe mekanizmat e ndërlikuar të raportimit fiskal kanë imponuar një barrë financiare mbi OSHC-të; dhe mungesa e proceseve transparente të përzgjedhjes nga bashkitë për krijimin e partneriteteve me OSHC-të.

Pavarësisht vështirësive të përmendura më lart, OSHC-të luajtën një rol qendror në ofrimin e shërbimeve sociale në vitin 2020. Programi i UNDP *Askush të mos mbetet pas* përzgjedhi pesëmbëdhjetë praktikat më të mira në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social në Shqipëri. Praktikrat më të mira nxorën në pah një sërë shërbimesh të OSHC-ve, përfshirë ato për personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, viktimat e dhunës me bazë gjinore, por edhe shërbimet në fushat e strehimit dhe shërbimeve shëndetësore, si dhe qendrat shumëfunktionale të komunitetit të vendosura në zona të ndryshme gjeografike. OSHC-të ofrojnë shërbime të tilla në koordinim me autoritetet lokale.

Projekti i PSH-së C.A.U.S.E. – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale është nisma e parë në Shqipëri që ofron aftësi dhe mbështetje financiare për OSHC-të për të krijuar sipërmarrje sociale duke përdorur asete, përfshirë ndërtesat, tokën dhe automjetet e konfiskuara nga krimi i organizuar. Projekti përgatiti një udhëzues praktik në shtator 2020 për të mbështetur OSHC-të në përpjekjet e tyre për të krijuar sipërmarrje sociale.

Tërmeti i vitit 2019 zbuloi kapacitetet e papërshtatshme të institucioneve shtetërore për t'iu përgjigjur emergjencave civile. Nga ana tjetër, aftësitë e OSHC-ve për t'iu përgjigjur shpejt nevojave të popullatës së prekur treguan rolin kritik që këto organizata mund të luajnë në reagimin ndaj krizave të tilla. Prandaj, bashkitë e prekura nga tërmeti u mbështetën në ndihmën e OSHC-ve dhe vazhduan të kërkonin mbështetjen e tyre edhe gjatë bllokimit kombëtar.

INFRASTRUKTURA E SEKTORIT 3.6



Infrastruktura që mbështet sektorin e OSHC-ve nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2020. Edhe pse gjatë vitit u organizuan më shumë trajnime, ato ishin kryesisht online, gjë që kufizoi efektshmërinë e tyre pasi shumë pjesëmarrës nuk ishin mësuar me mjetet online, OSHC-të e vogla nga zonat e largëta kishin më pak akses në këtë trajnime, dhe ndërveprimi midis pjesëmarrësve ishte i kufizuar.

QKBSHC ishte aktive gjatë vitit 2020. Ajo organizoi Akademinë e OJF-ve 2020, një nismë vjetore e fokusuar në rritjen e aftësive të drejtuesve të OSHC-ve, ndërtimin e partneriteteve dhe

forcimin e bashkëpunimit brenda sektorit. QKBSHC u siguroi OSHC-ve akses falas në platformat online për t'i ndihmuar ata të vazhdojnë aktivitetet e pezulluara nga pandemia, dhe ofroi trajnime përkatëse për OSHC-të në platformat online, mbledhje fondesh, advokim dhe lobim. Në dhjetor, QKBSHC organizoi *Konferencën Kombëtare të Shoqërisë Civile në Shqipëri* në një format online për të diskutuar çështjet që lidhen me zhvillimin e përgjithshëm të sektorit dhe rolin e tij në hartimin e politikave.

Grantet lokale ishin të kufizuara në vitin 2020, për shkak të fondeve të pamjaftueshme të donatorëve dhe mungesës së mbështetjes nga qeveria. Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC) përfundoi projektin ESCORI të financuar nga BE, i cili u përqendrua në ndërtimin e menaxhimit organizativ, menaxhimin e ciklit të projektit dhe kapacitetet e advokimit dhe lobimit të OSHC-ve të përqendruara në përfshirjen sociale të komuniteteve rome dhe egjiptiane. Gjithsej tridhjetë OSHC rome dhe egjiptiane morën mbështetje financiare përmes skemave të nëngrantimit të ESCORI-t që nga fillimi i tij deri në vitin 2020. CARITAS Albania ofroi gjithsej tetë grante në vitin 2020 të fokusuar në përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Instituti Shqiptar i Medias shpalli dy thirrje për propozime projektesh mbi lirinë e medias dhe pluralizmin në Shqipëri, ndërsa IDM ofroi gjashtë grante për përfshirjen e shoqërisë civile lokale në reformën e administratës publike. Grantet e këtyre projekteve do të fillojnë në 2021.

OSHC-të vijuan punën e tyre për të ndërtuar më shumë partneritete, koalicione dhe grupe formale dhe joformale në vitin 2020. Gjatë vitit, ndihma teknike e QKBSHC-së u përqendrua në adresimin e nevojave të rrjeteve, duke përfshirë konsolidimin e tyre të brendshëm, planifikimin strategjik, mentorimin dhe ngritjen e kapaciteteve në fusha të tilla si advokimi dhe lobimi, ngritja e fondeve dhe aftësia për të ofruar ndihmë teknike për anëtarët e tyre. Një grup profesionistësh dhe përfaqësuesish të OSHC-ve u mbledhën së bashku në një platformë virtuale të quajtur *Më Mirë së Bashku* për të ofruar informacion dhe shërbime bazë për familjet dhe individët që u gjendën të izoluar si rezultat i masave parandaluese të COVID-19. *Radari i Krimit të Organizuar i Ballkanit Perëndimor (WB-OCR)*, një nismë rajonale e shoqërisë civile, u formua në vitin 2020 për të thjeshtuar punën e shoqërisë civile dhe aktivistëve të angazhuar në luftën ndaj krimin të organizuar në nivel kombëtar dhe rajonal. Nga gjashtëdhjetë OSHC-të që janë pjesë e kësaj nisme, dhjetë prej tyre janë nga Shqipëria.

Bashkëpunimi midis OSHC-ve, bizneseve dhe institucioneve qeveritare mbeti i pazhvilluar gjatë vitit dhe ishte i kufizuar për shkak të masave kundër pandemisë si dhe fokusit të shoqërisë në kapërcimin e pasojave të saj. Siç u përmend edhe më sipër, institucionet publike rrallë marrin parasysh kontributin e OSHC-ve. Për më tepër, angazhimi selektiv i qeverisë me OSHC-të dhe prirja për të fshehur informacionin krijon marrëdhënie asimetrike. Siç vërehet në studimin *Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimarrjen në Shqipëri*, kjo asimetri strukturore çon në një qëndrim mjaft patronizues dhe refuzues ndaj OSHC-ve nga zyrtarët dhe institucionet publike.

IMAZHI PUBLIK 3.7



Imazhi publik i sektorit nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2020, pasi u vërejtën si zhvillime pozitive ashtu dhe zhvillime negative.

Megjithëse OSHC-të vazhdojnë ta kenë të vështirë sigurimin e mbulimit mediatic të veprimtarisë së tyre, një numër i shtuar i OSHC-ve përmirësuan imazhin e tyre në vitin 2020 duke artikuluar në mënyrë efektive kauzat e tyre përkatëse. OSHC-të gjithashtu publikuan një numër në rritje investigimesh dhe studimesh, të cilat u bënë pjesë e diskursit publik. Për më tepër, hapja e kanaleve të reja televizive në vend rezultoi në një rritje të lehtë të interesit të mediave për të mbuluar punën e OSHC-ve. Aktivizmi

dhe solidariteti i OSHC-ve ndaj tërmetit dhe pandemisë, rritja e përdorimit të mediave sociale dhe rritja e pranisë në media mund të konsiderohen të gjitha si përmirësime.

Pavarësisht këtyre përmirësimeve, media publike sërish nuk ofroi hapësirë të mjaftueshme për të mbuluar çështjet e trajtuara nga OSHC-të gjatë vitit 2020. Përveç kësaj, siç u theksua edhe gjatë punimeve të *Konferencës Kombëtare të Shoqërisë Civile*, “OSHC-të nuk kanë bërë investime të mjaftueshme në ndërtimin e urave të bashkëpunimit me mediat [...] për mbulimin [...] e çështjeve të trajtuara nga shoqëria civile.” Media lokale është më e aksesueshme, por edhe kjo është e vështirë të aksesohet në zonat e largëta ku shpesh ka vetëm një media ose nuk ka asnjë.

Ndërsa OSHC-të renditen sërish në vendin e katërt si institucionet e brendshme më të besuara në vend, besimi i publikut tek OSHC-të ka pësuar një rënie graduale. Sipas një sondazhi kombëtar të kryer në dhjetor 2020 nga IDM, gjithsej 52.6 përqind e të anketuarve u besojnë OSHC-ve, duke pësuar një rënie prej 3.7 përqind krahasuar me vitin e kaluar dhe 4.4 përqind më pak krahasuar me vitin 2018. Në mënyrë të ngjashme, 45 përqind e të anketuarve besojnë se OSHC-të e bëjnë qeverinë të përgjegjshme, një rënie prej 3 përqind nga viti i kaluar. Rreth 48 përqind e të anketuarve besojnë se interesat politike ndikojnë në punën e OSHC-ve, 3 përqind më shumë krahasuar me vitin e kaluar.

Kjo rënie e besimit mund t'i atribuohet disa faktorëve. Më të rëndësishmet janë fushatat e njollosjes të cilat janë përpjekur të diskreditojnë dhe çlegjitimojnë rolin dhe punën e shoqërisë civile në vend. Studimi i IDM-së *Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimarrjen në Shqipëri* vë në dukje se politikanët dhe media përhapin narrativa negative të OSHC-ve të tilla si "të kapura", "të blera" dhe "ndjekëse të parave". Faktori i dytë që kontribuon në zvogëlimin e besimit tek OSHC-të lidhet me pandeminë, e cila ndikoi drejtpërdrejt në punën e OSHC-ve në nivel kombëtar. Siç u theksua në studimin e WFD për *Rolin e Shoqërisë Civile dhe Medias në Menaxhimin e Krizave në Shqipëri*, ndikimi aktual i projekteve që u zhvendosën online ishte më i vogël se sa ishte parashikuar, pasi disa nga grupet përfituese të projekteve ishin ose të paarrtshme ose kishin nevojë për mbështetje në terren, e cila nuk ishte e bëshme.

Studimi *Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimarrjen në Shqipëri* vëren se ka mosbesim reciprok midis institucioneve publike dhe OSHC-ve. Komuniteti i biznesit, ashtu si aktorët e tjerë, u përqendrua në pasojat e pandemisë, prandaj, vazhdoi të ketë kuptim të kufizuar të rolit të OSHC-ve në shoqëri edhe gjatë vitit 2020.

Puna tradicionale në terren e OSHC-ve u kufizua gjatë vitit 2020 për shkak të masave kundër pandemisë. Si rezultat, OSHC-të përdorën mjete dixhitale për të punuar dhe për të arritur tek grupet përfituese të projekteve të tyre si dhe tek palët e interesuara. Edhe pse shumë OSHC ende nuk komunikojnë në mënyrë efektive, ato përmirësuan praninë e tyre në internet gjatë vitit 2020. Megjithatë, OSHC-të lokale kishin më pak gjasa të përdorin mjete online në punën e tyre.

Siç sugjeruan punimet e konferencës të publikuara nga QKBSHC, sektori duhet të përmirësojë standardet e punës së vet në mënyrë që të përmirësojë në mënyrë efektive imazhin publik dhe të rrisë besimin e publikut në punën e tij. Në vitin 2020, një grup pune prej tetëmbëdhjetë OSHC-ve iu bashkuan QKBSHC-së për të vazhduar punën për hartimin e Kodit të Standardeve për OSHC-të, i cili do të krijojë një mjet vetëvlerësimi që do të lejojë OSHC-të të matin në mënyrë efektive përparimin e tyre në fushat e transparencës, llogaridhënies, dhe qeverisjes së mirë.

* Ky publikim u bë i mundur nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID) sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr. AID-OAA-LA-17-00003.

* Mendimet e shprehura këtu janë të panelistëve dhe studiuesve të tjerë të projektit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose FHI 360.